



Albanian

Përtej dyerve të shkollës: përmbledhje raporti

Raport i botur në Maj 2008

'Përtej dyerve të shkollës' paraqet gjetjet e kërkimeve të ndërmarra si pjesë e *Projektit Përfshirja e Shkollave të Nivelit të Dytë (Inclusive Secondary Schools Project)*, i cili ka nisur në 2005, është kryer nga Këshilli i Refugjatëve dhe është financuar nga KPMG Foundation. Synimi i përgjithshëm i projektit ishte kërkimi dhe udhëzimi i modeleve të reja për bashkëpunim, që lidh shkollat me Organizatat Komunitare (OK). Raporti analizon gjetjet e fazës kërkimore, e cila zbulon nevojat dhe eksperiencat e refugjatëve dhe azil kërkuesve në lidhje me shkollimin në nivelin e dytë në Angli. Gjithashtu, *Projektit Përfshirja e Shkollave të Nivelit të Dytë* ka ngritur partneritetet udhëzuese ndërmjet shkollave dhe organizatave komunitare/përkrahëse për refugjatët, me qëllim adresimin e faktorëve që ndikojnë tek përfshirja e prindërve/kujdestarëve dhe zhvillimin e praktikave të vlefshme. Gjetjet e marra, si nga kërkimi ashtu dhe nga fazat e zhvillimit, formojnë themelet e paketës informative për shkollat dhe organizatat komunitare/përkrahëse të refugjatëve. Kjo paketë do të përdoret për të rritur përfshirjen e komunitetit të refugjatëve në edukimin e të rinjve refugjatë dhe azil kërkues.

Kërkimet e analizuara në raport, përbëhen nga 70 intervista të detajuara, si dhe anketime të bëra me OK, shkollat e nivelit të dytë dhe autoriteteve vendore, në mënyrë që:

- Të shqyrtohen eksperiencat dhe nevojat e këtyre grupeve
- Të identifikohen pengesat kyçe ndaj përfshirjes, dhe
- Të identifikohen shembuj të praktikave që kanë për synim kapërcimin e këtyre pengesave.

Konteksti legjislativ dhe rregullator, si edhe struktura e kërkimit, analizohen në mënyrë të detajuar në kapitujt dy dhe tre. Kapitulli katërt zbulon eksperiencat e të rinjve dhe të prindërve/kujdestarëve lidhur me arsimin e nivelit të dytë shkollor. Kapitulli i pestë shqyrton pengesat ndaj hyrjes dhe arritjeve në arsim, ndërsa kapitulli i gjashtë thekson ato praktika të cilat ndihmojnë komunitetet e refugjatëve për t'i kapërcyer pengesat. Raporti përfundon me rekomandimet që janë përpiluar për t'i ardhur në ndihmë grupeve të interesit, në mënyrë që të përmbushin sa më mirë nevojat e komuniteteve të refugjatëve.

Ekspierenca dhe angazhime

Tek të rinjtë në këtë paketë kërkimore, vihet re një përfshirje e gjërë e prindërve/kujdestarëve, në masa të ndryshme, psh nga një takim i vetëm, deri te takimet e shpeshta. Megjithatë aftësitë në gjuhën angleze mund të ishin pengesë, prindërit vazhduan të përpiqen për t'u angazhuar pavarësisht kësaj vështirësie. Të rinjtë përgjithësisht ishin shumë pozitiv për përkrahjen e marrë nga prindërit/kujdestarët e tyre.

Prindërit/kujdestarët, përgjithësisht, ishin të kënaqur me shkollat. Niveli i përfshirjes së tyre ishte i lartë, sidomos kur kishin përkrahjen e një komunikimi të mirë me shkollën dhe të një stafi të gjindshëm dhe ndihmues. Disa prindër/kujdestarë sugjeruan mënyra të tjera sesi mund të përmirësohej angazhimi i tyre, psh nepërmjet një komunikimi më të mirë dhe dhënia e reagimeve nga shkollat.

Shkollat e identifikonin angazhimin efektiv si një faktor të rëndësishëm në mirëqenien dhe arritjet e të rinjve, si edhe për fuqizimin e prindërve/kujdestarëve për të marrë pjesë në arsimimin e fëmijëve të tyre. Megjithatë, disa nga shkollat kanë hasur vështirësi në marrëdhëniet me disa prindër/kujdestarë, dhe theksuan rëndësinë e një mjedisi mikpritës dhe nxitës.

OK, sipas studimeve, afrojnë një sërë shërbimesh edukative, të zhvilluara si rezultat i nevojave që u janë prezantuar atyre, duke përfshirë këtu shqetësimet për rezultate jo të mira të nxënësve, si dhe nevojën për ndihmë me detyrat e shkollës dhe ndaj problemeve me sjelljen. OK ka identifikuar gjithashtu rëndësinë e rritjes së nivelit të rezultateve në shkollë, të iniciativave për të promovuar trashëgiminë dhe gjuhën e të rinjve, dhe të ndihmesës ndaj prindërve/kujdestarëve për t'u integruar përmes mësimi të anglishtes. OK thekson veçanërisht nevojën për përkrahjen e prindërve/kujdestarëve duke qënë se në disa raste është më e vështirë për ta të integrohen, sesa fëmijët e tyre.

Pengesat ndaj përfshirjes

Paketa kërkimore identifikoi një sërë pengesash kyçe, të cilat mund të pengojnë përfshirjen e të rinjve refugjatë e azil kërkues, si edhe të prindërve/kujdestarëve në arsimin e nivelit të dytë shkollor.

- Të anketuarit kishin një sërë **vështirësë thelbësore për të hyrë në ambjentet shkollore**, përfshirë këtu vonesat e tejzgjatura (deri në shtatë muaj) duke pritur për tu futur. Megjithë përkrahjen e dhënë nga një sërë burimesh, për shumë nga të anketuarit këto vonesa nuk u parandaluan.
- **Ngacmimet fyerse dhe racizmi** janë ngritur si çështje shqetësuese nga të rinjtë dhe OK. Të rinjtë kanë raportuar se ndihen në siklet të tregojnë se ishin refugjatë ose azil kërkues, apo të flisnin për të kaluarën e tyre nga frika e përgojimit. OK e ka identifikuar këtë si një çështje me të cilën ata merreshin shpesh.
- **Familjet raportuan pengesa financiare ndaj përfshirjes**, të tilla si mungesa e perkrahjes financiare për aktivitete jashtë-shkollore, dhe vështirësi për të siguruar librat, uniformën si dhe materiale të tjera shkollore. Kjo gjë, ndikonte negativisht në aftësinë e këtyre të rinjve për tu integruar në shkollat që ata ndiqnin.
- **KO kanë raportuar gjithashtu një mungesë burimesh financiare dhe informuese**, të cilat sjellin vështirës për të siguruar fonde për afrimin e shërbimeve edukative, si dhe për të gjetur ambiente falas ose pa pagesë, për të zhvilluar këto shërbime.
- Të dyja, si OK ashtu edhe shkollat kanë hasur **pengesa burimesh financiare për të afruar trajnime efektive** për stafin dhe mësuesit, duke kufizuar aftësitë e tyre për të dhënë këshilla të përshtatshme apo për të ndërgjegjësuar mësuesit.
- Mungesa e komunikimit në anglisht ishte një pengesë madhore për angazhimin efektiv me prindërit/kujdestarët në proceset edukative. Shkollat kanë raportuar vështirësi **për të komunikuar progresin shkollor të nxënësve**, sidomos kur varen nga **të rinjtë si përkthyes**.
- **Sistemi britanik i azilit** krijon në vetevete një sërë pengesash, duke përfshirë këtu pasigurinë që përjetojnë azil kërkuesit, të cilët janë tashmë në shkollë, por kanë frikë se do të shpërngulen. Varësia ndaj akomodimit të përkohshëm dhe të shpërndarë do të thotë **se fëmijët janë të detyruar të rivendosen vazhdimisht në shkolla të reja**, gjë e cila

mund të ketë një ndikim tejet negativë për socializimin e tyre, për të mbajtur miqësi dhe për të marrë përkrahje nga komuniteti.

- **Përjetimi i traumave dhe i udhëtimeve** mund të kenë një ndikim të thellë në sjelljet e fëmijëve, veëanërisht në marrëdhëniet e tyre me mësuesit dhe moshatarët.
- Të rinjtë dhe prindërit/kujdestarët mund të përjetojnë **një mungesë familiariteti me sistemin shkollor**, dhe shpesh herë ndihen të frikësuar dhe të hutuar nga vetë shkollat.
- Megjithë faktin se OK mund të shërbejë shumë mirë për të ndihmuar në përmirësimin e rendimentit të shkollave, mosmundësia e tyre për të hyrë në to, si edhe paaftësia e shkollave për të identifikuar dhe kontaktuar OK, mund të krijojnë një **mungesë bashkëpunimi** për prekjën e këtyre probleme.

Përmbushja e nevojave të refugjatëve dhe azil kërkuesve

Projekti identifikoi një sërë praktikash si përgjigje ndaj pengesave të përshkruara si mësipër. Këto praktika përfshijnë:

- Sigurimi i një statusi më të gjërë shkollor i cili afron veprimtari përtej ditës normale shkollore, në mënyrë që t'i ndihmojë prindërit/kujdestarët refugjatë për të luajtur një rol më të madh në shkollë dhe më gjërë, si dhe të angazhojë të rinjtë.
- Disa OK kanë përfutur me sukses fonde për afrimin e veprimtarive edukative.
- Disa shkolla kanë punësuar personel që është marrë me shkollën e zhvilluar në shtëpi dhe të tjerë që kanë marrëdhënie me komunitetin, të cilët sigurojnë lidhje të rëndësishme mes komuniteteve dhe shkollave. Disa shkolla të tjera kanë përdorur qendra informale avokacie për të luajtur këtë rol.
- Shkollat dhe OK kanë raportuar përdorimin e keshilluesve të moshatarëve për t'i ndihmuar nxënësit me mësimet, si dhe për t'i nxitur dhe përkrahur ata.
- Një numër i vogël shkollash kanë ndërtuar marrëdhënie të mira me shërbime dhe organizata të specializuara për të afruar përkrahje psiko-sociale për të rinjtë e traumatizuar.
- Përkrahja për mësimin e gjuhës është parë si thelbësore, gjë e cilat zakonisht është siguruar nëpërmjet institucioneve shtetërore. Megjithatë, janë identifikuar dhe metoda të tjera, të tilla si shkollat e së Dielës të drejtuara nga shkollat dhe OK.
- Disa shkolla kanë raportuar se përdorin materiale të përkthyer për prindërit/kujdestarët, si edhe sigurojnë përkthyes gojor.
- Shumë shkolla afrojnë udhëzime të përshtatshme për të rinjtë dhe prindërit/kujdestarët, që kanë në përmbajtje informacione për procesin e pranimit në shkolla, kurikulën dhe mundësitë e angazhimit në to. Disa shkolla kanë krijuar broshura të përkthyer të përshtatshme për nevojat e të rinjve refugjatë.
- OK kanë siguruar gjithashtu dhe informacion për prindërit/kujdestarët lidhur me sistemin anglez të shkollimit, duke përfshirë këtu këshillime sy më sy dhe kurse trajnimi se si t'i ndihmojnë fëmijët e tyre me shkollën.
- Disa shkolla kanë krijuar metoda të vazhdueshme angazhimi, të tilla si mëngjese kafeje dhe seksione qasjeje të grupeve të komunitetit refugjat.
- Janë dhënë shembuj lidhur me bashkëpunimin mes shkollave të nivelit të dytë dhe OK për të përmirësuar eksperiencën arsimore të të rinjve refugjat dhe azil kërkues, si dhe të prindërve dhe kujdestarëve.

Përfundime dhe rekomandime

Raporti përfundon me dhënien e rekomandime të vlefshme për të ndihmuar grupet e interesit që të përmbushin sa më mirë nevojat e komuniteteve refugjate. Këto grupe interesi përfshijnë shkollat e nivelit të dytë, autoritetet vendore, OK, organizatat dhe departamentet qeveritare që përkrahin refugjatët.

Raporti i plotë kërkimor, gjetjet nga anketimet dhe një paketë burimesh financiare dhe informacioni për të ndihmuar shkollat dhe OK në plotësimin e nevojave të fëmijëve refugjatë, e publikuar si pjesë e *Projektit Përfshirja në Shkollat e Nivelit të Dytë (Inclusive Secondary Schools Project)*, mund ta gjeni tek: www.refugeecouncil.org.uk/inclusiveschools